

Nathalie Handal
Parashtrësë nga Karolin Forshe

Parashtrësë

Në librin *Freskitë e Shiut*, Nathalie Handal ka sjellë një vepër që flet për zhvendosjen dhe pasigurinë radikale, duke lëvizur prej një kontinenti në kontinent tjetër, duke u shprehur për Palestinezët e diasporës me një theks ndaj zgjimit të fortë dhe zemërdhembshurisë, duke e kundërshtuar luftën, okupimin dhe vrazhdësinë që e paraqet gjuha e saj burimore, duke u shprehur për ullinjtë, tufanin, *kopenë me dele apo malin i cili digjet*, muzikën e radios, vështrimin e fluturës. Kjo është një poezi e cila asnjëherë nuk arrihet, e cila flet për fshatrat e zhdukur nga faqja e dheut, për belat me tatuazhe dhe për kallashnikovët, për dhinë dhe për kufomat e prera copë më copë, për shtëpitë e paraqitura si burgje. Me një gjuhë të lirë dhe të gdhendur pa e zbukuruar edhe aq shumë, ajo shkruan lirikë për mërgimin duke e përzier me arabishten, anglishten, spanjishten dhe frëngjishten në një testament poligloti të tmerrit dhe mbijetesës. Te *Habibti, que tal?* ajo i fton ata të cilët bredhin prej një vendi në një tjetër, ndërsa ata që janë lënë pas në Jenin, qytetin Gaza, dhe Bethlehem jetojnë *me një të kaluar të përgjakshme / në qytete të izoluara*. Ajo flet për kujtesën dhe harresën, rrezikun nga identiteti dhe brishtësinë e bashkësisë njerëzore; poezia e saj është një përvojë e vuajtjes pa kufi. Handal është poete e shkathët e cila i paraqet paradokset dhe ndryshimet e konsiderueshme të kohës, poete e përjetimeve ndijimore dhe e fshehtësirave që kanë ngelur ende të pazgjidhura. Gjuha të cilën ajo e përdor është e brishtë nga historia dhe e shënjuar me mbresa deri në skaj; e mbushur me një elegancë dhe mençuri të rrallë.

—Karolin Forshe

Ephratha

Atje po qëndron
mes ëndrrës së dy gazelave,
pa frymë
pyes poemën

Poemë
e veshur me degë ulliri dhe lumturinë e çjerrë
e rrethuar me netë të ndezura nëpër stinë pa gjumë
në qytete me mure të pluhurosura ku aty kemi humbur

Poemë
e cila e humb adresën apo adresa po humbet,
të dyja, në cilindo rast duke pritur
kthimi i atyre që s'kthehen as sot e as nesër

Poemë
e cila dëshiron që t'i kujtohet nëse mjegullat thyhen përgjysmë
ditën kur ushtarët parakaluan nëpër fshatrat tona, qytetet,
shtëpitë, ëndrrat dhe ardhmëria, mbajnë mend lutjet e shkërmoqura
mbaj mend zbrazëtinë në mes të duarve që mbërthyen të tërë
e që poema ishte tepër e pakuptimtë,
kujtoj kur u ishim dorëzuar të fshehurave të kuajve,
atëherë kur ne kishim bërë mëkat

Poemë
të pyes, përse,
mos vallë rrugët kanë emër të cilin unë nuk po mundem ta shqiptoj?
Apo tërësia e fjalëve neve na ka shpikur, shqiptimet tona
na e kanë zilinë? A duhet patjetër të ndalemi
dhe të mundohemi ta themi emrin tonë pa ndjenja?
Të provojmë t'i lavdërojmë poetët tanë pa u frikësuar?

Poemë
a është mërgimi
një mysafir i bërë prej gurësh
një vijë e hollë në mes zërit tonë dhe grykës së parajsës?

Poemë
a janë kujtimet tona të shënuara në fletore të zbehta,
ngjyra të trilluara, mure të rrëzuar
për ta kuptuar këtë vend a duhet që ne patjetër t'i kuptojmë rënkimet e tij,
për ta kuptuar rënkimin a duhet që ne patjetër t'i kuptojmë vargjet e tij,
për t'i kuptuar vargjet e tij a duhet që patjetër ta kuptojmë agoninë?

Poemë

gurgullima e lumenjve në gjoksin tënd të gjarpëruar,
gjethet në duart tua të valëzuara, çatia që ndahet
fushat me fletë, kama dhe stuhia
gjithkund brenda teje

Poemë

më trego kur fjalët e tua do të mbushen me truall, varri yt me qumësht,
fushat tua me grurë, manastire, sinagogë,
kryqet dhe arkivolet e tua do të ndalen së qepuri milje me kocka,
më trego kur do të ndalen së transmetuari vetveten në radio?

Poemë

qëndro në mes ëndrrës së dy pyetjeve
duke pritur që drita të të nxjerrë në mëngjes
sikurse lutjet që dalin nga gojëzat,
t'i vazhdo të qëndrosh, qaj dhe festo
siç të ishe shkruar
në mënyrë të përkryer